



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE**



Datë: 05.04.2012

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2012, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 26, të datës 23.03.2012, paraqitur nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 17, shkronja (e, f, p) dhe nenin 40, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12.1, shkronja (d, dh, l,) dhe nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 56, i datës 29.04.2010, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet Plani Lokal i Veprimit për krijimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe rekreative për qytetarët, në qytetin e Fushë-Kosovës, për periudhën 2012-2013.
- II. Plani Lokal i Veprimit rregullon përmirësimin e shërbimeve për mbrojtjen e mjedisit dhe parasheh krijimin, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara dhe rekreative në qytetin e Fushë-Kosovës.
- III. Obligohet, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Shërbime Publike për zbatimin e Planit Lokal të Veprimit, të cekur në pikat një (1) dhe dy (2) të vendimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Drejtorisë për PUKMM, Drejtorisë për SHP dhe Arkivës.



**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Jakup Tërnavë**